



REPUBLICA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT FIER
SEKTORI JURIDIK

Nr. 6745/41
DH-0601.2023

Nr. 1323/1 prot.

Fier, më 05.01.2023

Lënda: Kthim përgjigje për verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve Nr. 65 dhe Nr. 66, të Këshillit të Bashkisë Divjakë, të miratuara në mbledhjen e datës 23.12.2022.

BASHKISË DIVJAKË
KËSHILLIT TË BASHKISË DIVJAKË

Divjakë

Në përgjigje të shkresës Tuaj me Nr. 6745/37 prot. datë 28.12.2022 protokolluar në Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier me Nr. 1323 prot. datë 30.12.2022, bazuar në ligjin Nr. 107/2016, "Për Prefektin e Qarkut" neni 8, shkronja "a", neni 16 si dhe në ligjin Nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative" neni 3, pika 2, pasi verifikuam ligjshmërinë e vendimeve me karakter normativ të Këshillit të Bashkisë Divjakë, të miratuara në mbledhjen e datës 23.12.2022, shoqëruar me procesverbalin e mbledhjes Nr. 17, datë 23.12.2022, të mbajtur në Librin e Procesverbalit të Mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë Divjakë me Nr. 2717 prot. datë 09.07.2021, procesverbalet e dëgjësës publike si dhe dokumentacionin plotësues të vendimit, shprehemi si më poshtë:

Vendimi i Këshillit të Bashkisë Divjakë Nr. 65, datë 23.12.2022, "Mbi miratimin e buxhetit, numrit maksimal të punonjësve të bashkisë dhe ndërmarjet vartëse të bashkisë për vitin 2023", shoqëruar nga projektvendimi Nr. 77, datë 16.12.2022, i protokolluar me Nr. 6745/17 prot. datë 16.12.2022, relacioni Nr. 6715/18 prot. datë 16.12.2022, procesverbali i dëgjësës publike Nr. 4, datë 26.10.2022, Nr. 6, datë 27.10.2022, Nr. 12, datë 01.11.2022, Nr. 8, datë 02.11.2022, është në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" neni 8, pika 2, neni 9, pika 1.1, shkronja "b", 1.3, shkronja "c", neni 41, pika 1, neni 54, shkronja "dh"; Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar) neni 3, pika 1, neni 6, neni 15, neni 32, Ligjin Nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 6, shkronja "d", neni 40, neni 41, pika 3; si dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit".

Vendimi i Këshillit të Bashkisë Divjakë Nr. 66, datë 23.12.2022, "Mbi miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 për Bashkinë Divjakë", shoqëruar nga projektvendimi Nr. 78, datë 16.12.2022, i protokolluar me Nr. 6745/19 prot. datë 16.12.2022, procesverbali i dëgjësës publike Nr. 4, datë 26.10.2022, Nr. 6, datë 27.10.2022, Nr. 12, datë 01.11.2022, Nr. 8, datë 02.11.2022, Ju kthehet për plotësim për arsyet e mëposhtëme: